



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE

**AKT NORMATIV**

Nr.\_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_

**PËR**

**DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.99/2018, “PËR BUXHETIN  
E VITIT 2019”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

Në ligjin nr.99/2018, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

**Neni 1**

Neni 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

**“Neni 4**

Buxheti i sigurimeve shoqërore për vitin 2019 është, si më poshtë vijon:

I. Sigurimi i detyrueshëm, programet kompensuese dhe trajtimet e veçanta.

|                       |                       |
|-----------------------|-----------------------|
| Të ardhurat, gjithsej | 127 534 milionë lekë; |
|-----------------------|-----------------------|

Nga të cilat:

|                                                      |                      |
|------------------------------------------------------|----------------------|
| - kontributet                                        | 82 896 milionë lekë; |
| - transferimet nga buxheti i shtetit                 | 38 232 milionë lekë; |
| - teprica e rezultatit financiar të vitit 2018       | 2 106 milionë lekë;  |
| - transferta nga buxheti për indeksimin e pensioneve | 2 310 milionë lekë;  |
| - transferta për bonusin e pensionistëve             | 1 990 milionë lekë;  |

|            |                       |
|------------|-----------------------|
| Shpenzimet | 127 534 milionë lekë. |
|------------|-----------------------|

Paga minimale, për efekt të pagesës së kontributit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, është e barabartë me pagën minimale në shkallë vendi dhe ndryshon sa herë që ndryshon kjo pagë. Këshilli i Ministrave përcakton masën e kontributit për personat e vetëpunësuar në bujqësi, si dhe të kategorive të veçanta të personave të vetëpunësuar. Për vitin 2019, teprica ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve, sipas degëve dhe programeve të sigurimit shoqëror të detyrueshëm e suplementar, përdoret për mbulimin e deficitit të degës së pensioneve.

## 2. Sigurimi suplementar

Të ardhurat, gjithsej 5 844 milionë lekë;

Nga të cilat:

- kontributet 1 446 milionë lekë;
- transferimet nga buxheti i shtetit 4 258 milionë lekë;
- fondi për indeksimin e pensioneve 140 milionë lekë;

Shpenzimet 5 844 milionë lekë.

Fondi për indeksimin e pensioneve është parashikuar 2 450 milionë lekë. Përdorimi i këtij fondi bëhet sipas përcaktimeve në nenin 61, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Shpenzimet administrative, si pjesë e shpenzimeve totale për skemën e sigurimeve shoqërore, janë jo më shumë se 2 618 milionë lekë dhe ndahen sipas skemave në proporcion me shpenzimet e drejtpërdrejta.”.

Bonusi i pensionistëve, në masën 3 000 lekë për pensionist, zbatohet nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Posta Shqiptare, sh.a. Pagesat respektive kryhen në muajin dhjetor të vitit 2019 dhe gjatë fillimit të vitit 2020.

## Neni 2

Në nenin 10 bëhen këto ndryshime:

- a) Në paragrafin e parë, zëri “Fondi rezervë” bëhet 2 235 milionë lekë;
- b) Tabelat 1 dhe 4, të përmendura në nenin 10, zëvendësohen, përkatësisht, me tabelat me të njëjtin numërtim, që i bashkëlidhen këtij akti dhe janë pjesë përbërëse e tij.”.

## Neni 3

Paragrafi i parë, i nenit 13, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Fondi rezervë i buxhetit prej 2 235 milionë lekësh përdoret nga Këshilli i Ministrave për raste të paparashikuara të njësive të qeverisjes së përgjithshme.”.

#### **Neni 4**

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren zyrtare”.

**K R Y E M I N I S T R I**

**EDI RAMA**

MINISTRI I FINANCAVE  
DHE EKONOMISË

ANILA DENAJ